



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1803/11 Prot.

Tiranë, më 03.03. 2026

UDHËZIM

Nr. 5, datë 03.03. 2026

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.07.2023, “PËR
NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË
PUNONJËSVE ARSIMORË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d” të pikës 2, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:
 - a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi “Ministria e Arsimit dhe Sportit” zëvendësohet me “Ministria e Arsimit” dhe akronimi “MAS” zëvendësohet me “MA”.
 - b) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “Arti skenik” zëvendësohet me togfjalëshin “Arte skenike”.
 - c) Në pikën 3, të shtojcës 1, për lëndët “Art Pamor”, “Muzikë” dhe “Kërcim”, te profili i përafërt të shtohet “Arte skenike”.
 - d) Në shkronjën “a” të pikës 4 të shtojcës 1, për lëndën “Ekonomi”, profili i kërkuar të bëhet “Ekonomi” dhe profili i përafërt të bëhet “Shkenca Sociale”.
 - e) Në shkronjën “b”, të pikës 4 të shtojcës 1, për lëndën “Arte”, te profili i kërkuar të shtohet “Koreografi”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

